REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr: 2829

Maliq,më 23 - 5 2025

PROJEKT –VENDIM – NR. 6

Për

" Rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025 "

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjene fondeve buxhetore", te ligjit Nr 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", mbështetur në vendimin nr 130 dt 26.12.2024 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 " Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 2 Datë 24.01.2025 »Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025 » , propozoj miratimin e këtij projekt –vendimi nga këshilli duke vendosur :

1-Të miratojë rishpërndarjen e buxhetit për vitin 2025 si më poshtë :

Pakësim :

Gr	Kap	Kod prog	llog ek	kodi	Objekti	vlera në lekë
00	05	01110	231		Bashkefinancim projektesh	2,000,000

Shtesa :

00	05	01110	602	9999999	Projekt : " NATUREFIN " (Programi Interreg Europe)	2,000,000

2.Vlera e këtij projekti do të financohet si më poshtë

- në vitin buxhetor 2025 2,000,000 lekë

- në vitin buxhetor 2026 2,000,000 lekë

- në vitin buxhetor 2027 1,000,000 lekë

3.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

Konceptoi : A.Muka

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Nr: 2829

Nr: 23.525

RELACION

Për:

Miratimin e rishpërndarjens së buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025 për Projektin "NATUREFIN" në programin Interreg Europe.

Projekt Vendimi që po ju paraqesim ka të bëjë me një aplikim të suksesshëm të Bashkisë Maliq në bashkëpunim me disa Partnerë.

- -Corvinus Universiteti I Budapestit
- -Këshilli I Qarkut Hungari
- -Finland
- -Bashkia Paggaio, Greqi
- -Komuniteti Ndërkomunal I Beiras dhe Serra da Estrela, Spanjë
- -Këshilli I Provincës së Badajoz
- -Bashkia Maliq

Nëpërmjet këtij projekti Bashkia Maliq synon të arrijë objektivat e tij mjedisore dhe të nxisë një rritje ekonomike afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Objektivi parësor i projektit është të përmirësojë Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Maliq duke ndërhyrë konkretisht në:

- Zbutjen e ndikimeve në cilësinë e ajrit;
- Adresimin e çështjeve të cilësisë së ujit;
- Menaxhimi i ndikimeve në peizazh;
- Ofrimi i zgjidhjeve për pikat e nxehta mjedisore
- Parashikimi i shtimit dhe zgjerimit të hapësirave të gjelbra.

Karakteristikat kryesore përfshijnë zbatimin e masave për trajtimin e ndikimeve në ajër, ujë, peizazh dhe pika të nxehta, si dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra. Kjo përfshin modernizimin e infrastrukturës për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, planifikimin e qëndrueshëm të përdorimit të tokës dhe ndërhyrjet e synuara për pikat e nxehta mjedisore. Masat prioritare të adresuara nga kjo politikë përfshijnë ngritjen e mekanizmave monitorues dhe zbatues për të siguruar përputhjen me standardet mjedisore dhe futjen e stimujve për bizneset dhe komunitetet për të adoptuar praktika të qëndrueshme që ndikojnë në natyrë dhe biodiversitet.

Gjatë projektit NATUREFIN, njohuritë e përbashkëta dhe praktikat më të mira do të informojnë rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, duke siguruar që ai të përditësohet për të pasqyruar instrumentet dhe strategjitë më të fundit të financimit të qëndrueshëm.

Ky rishikim do të plotësojë synimet më të gjera të bashkisë për zhvillim të qëndrueshëm urban duke specifikuar zonat e gjelbërta të investimeve dhe duke identifikuar instrumente të përshtatshme financimi, duke përfshirë fondet e investimeve ekologjike dhe financimin e

infrastrukturës së gjelbër. Për më tepër, plani i përditësuar do të përputhet me rregulloret e financimit të qëndrueshëm të BE-së, duke ofruar akses të zgjeruar në mundësitë e investimeve që mbështesin qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekonomike afatgjatë. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, Bashkia Maliq synon të rrisë cilësinë e saj mjedisore dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm.

Për implementimin e këtij projekti na nevojitet një fond prej 5.000.000 ALL I cili do të përdoret në 3 vite.

Sipas Marrëveshjes ky fond do të financohet fillimisht nga Bashkia Maliq dhe pas raportimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve do të rimbursohet nga fondi i Projektit.

Faleminderit!

Konceptoi: I.Polena Dt. 23.05.2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ